

LLAMBRO KRISTO

KRONIKE

për ditët e luftës

roman

BIBLIOTEKA
SHTETIT

PSH-31
K 95



85H-31
K P 5

LLAMBRO KRISTO

KRONIKE PËR DITET E LUFTËS

R o m a n



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TI SHTYPSHONJA

KRONIKE PËR DITËT
E LUFTËS

M. O. M. O. N.

Tirazhi 10.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1976

D J A L O S H I

Atë të diel marsi të vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e tre, qyteti i vogël buzë Vjosës ishte akoma i përgjumur. Në kall-drëmet e rrugëve, vende-vende të ronitura «nga kujdesi i tepërt i Bashkisë», jehonin akoma hapat e rëndë të patrullave të koprifuokos,¹⁾ që ktheheshin në kazermat.

Diku çelej një dritare dhe një fytyrë e përgjumur gruaje hidhte vështrimin kureshtar në rrugët e heshtura.

Nga Mali i Dhëmbelit zbriste puhiza pranverore, që sillte me vete aromën e luleve të egra të porsaçelura në Korijen e Sedes.

Thëllimi i mprehtë i lumit ndeshej me puhizën e malit: ndeshej dimri me pranverën mbi qytet. Dëbora që kishte rënë disa ditë më parë nuk kishte shkrirë e tëra. Vende-vende, mbi çatitë e shtëpive të mbuluara me rrasa të mëdha guri të rrafshët zbardhëllonin gjurmët e dëborës. Dielli, që i lëshonte akoma pjerrtas rrezet e tij, nuk kishte mundur t'i spastronte ato gjurmë?.

Djaloshi Vangjel Gërdushi u vërtit sa u vërtit në shtratin e ngrohtë e u zgjua. Po zgjohej herët, sado që në mbrëmje kishte menduar se do të zgjohej vonë, do të ngopej me gjumë. Fërkoj sytë e u shtriq, ngaqë e ndiente trupin si të mpirë. Hodhi vështrimin e përgjumur te dërrasat e tavanit të vjetër, nga pjesët e çara të të cilave zbriste një rrymë e ftohtë ajri. Mendoi të ngrihej, të vishej, por hoqi dorë hëpërhë. U mbështoll mirë me jorganin e vjetër, me çarçaf të arnuar, por të pastër, që mbante erë ftua e naftalinë, erë karakteristike e sepeteve të grave, duke shpresuar mos e zinte gjumi përsëri.

1) Patrullat fashiste që kishin të drejtë të hapnin zjarr pa paralajmërim në kohën e ndalimqarkullimit.

E ëma, që flinte në krahun tjetër të dhomës, u zgjua nga lëvizjet e tij. Ashtu e përgjumur, foli me zërin e thekshëm të nënës zemërdhembshur, dënuar nga jeta:

— U zgjove, bir?

— Po, nënë.

— Prit, bir, mos u ngre, ja, sa të ndez zjarrin në magjiro.¹⁾

— U ngrit mbi njërin bërryl; me krahun tjetër u ra flokëve thinjoshë, të shpupurisur nga gjumi, dhe i hodhi një vështrim të përmallshëm, hetues të birit: «Vallë, ç'të ketë djali, që u zgjua kaq shpejt sot?» U vesh me ngut e shkoi në kuzhinë.

Djaloshi vazhdonte të vërtitej në shtrat. Ai porsa kishte hyrë në të nëntëmbëdhjetë pranverat. Kishte trup të zhvilluar e të lidhur mirë, sado që dukej pakëz i zbetë, gjurmë kjo e jetës së vështirë që kalonte familja e tij. Balli i tij i gjerë e i pastër pritej nga brazat e thella, që dëshmonin se mendime të shpeshta, të ngjeshura, rrihnin mendjen e tij. Ndjenja e mendime, kjo ishte bota e tij atë çast. I dukej sikur kishte rënë në fundin e një honi e nuk gjente dot rrugëdalje.

U shtriq përsëri; mendoi të ngrihej, iu kujtua porosia e s'ëmës; u shtri në shtrat e u mbulua me një lëvizje të plogësht. Mendimet u topitën për një çast. Rrudhat e ballit u rralluan. Por ky ishte vetëm një çast. Mendimet e turbullta ua lanë vendin kujtimeve të hidhura. Iu kujtua fëmijëria, shkolla, ëndrrat që u zhdukën si vesa e mëngjesit atë ditë të kobshme, këtu e shtatë vjet më parë, kur erdhi ajo letra ogurzezë nga Stambolli. Kishte qenë një djalë i përkëdhelur e gazmor, si bir i vetëm midis tre pleqsh. Në kujtesën e tij kishin mbetur të forta, të pashlyeshme, kujtimet e atyre çasteve fatale: letra me zarfin me shirit të zi. Oh, kur e kujtonte atë letër, i rrëqethej trupi! Mوندohej ta largonte, ta fshinte fare nga kujtesa, por më kot. Ajo letër vazhdonte t'i kujtohej, veçanërisht kur ndihej i pezmatuar. Vazhdonte ta përfytyronte letrën si një lubi kërcënuese, që kishite prishur jetën e tij. Kur që i mitur, gjithë fajin ia hidhte letrës; tani që po rritej, e kuptonte se nuk që fajtoje vetë letra, por diçka tjetër; kurbeti! Një mallëkim shekullor për meshkujt. «Djali që rritet, bëhet për kurbet!» — dëgjohej të thoshin shpesh. Edhe pse kishin kaluar vite, djaloshit i kujtohej qartë, sikur të

1) kuzhinë.

kishte ndodhur dje, se si xha Dhimoja, i ungji, e kishte marrë në dorë letrën me shirit të zi, se si i dridheshin gishtat tek po e çelte, se si e shikonin plakat në sy, të nemitura... I kujtohej se si u tregoi plakave xha Dhimoja, me zë të mekur, se ç'kishte ndodhur. Babai i Vangjelit kishte vdekur nga një aksident, dyqani i vogël prej druri ishte bledur nga një difekt i korentit elektrik. I ati, që flinte aty brenda, kishte gjetur vdekjen ndër dallgët e zjarrit. «Ah, ky kurbeti! Sa kohë vendi ynë do t'ia ketë nevojën kurbetit?!» Dhe djaloshin e mbyste një ndjenjë e hidhur.

Dielli ishte ngritur një hosten midis reve. Si për të dëbuar mendimet e zymta, e flaku tej jorganin e u çua. Koka e rënduar i ziente si fole grenzash nga pleksja e mendimeve, e ndjenjave, e kujtimeve. U ngrit e shkoi në kuzhinë. U pastrua shpejt e shpejt e doli në oborr. Ajri i freskët i mëngjesit ia davariti disi zymtësinë e fytyrës. U sorollat një copë herë nëpër kopsht, pa ditur ç'të bënte. Uri nuk kishte. Vendosi të dilte.

Mëngjesi ishte i mjegullt. Retë e dendura në qiell lëvrinin të nxituara. Dielli e kishte vështirë të çante rrugë midis tyre. Një shi i imtë e i ftohtë ia shtonte trishtimin atij mëngjesi. Nën një tendë llamarine mbi derën e hyrjes së shtëpisë, që zhuzhiste lehtë nga pikat e imta të shiut, xha Dhimoja po kruante me limë druri një bisht sqepari. Plaku që zhytur në punën e tij. Djaloshi, që kaloi midis oborrit, e pyeti me drojtje:

— Përse të duhet ky, xhaxha?

— Njeriu nuk punon kot, nipçe, më duhet, pa e bëj!... Ti si i ke punët me ustanë?

— Mirë, xhaxha.

— Të ndihmon?

— Po. Më ndihmon... më jep punë.

— Po, po, punë të jep, po a të jep zanat, — dhe sytë e plakut shkrepnin nga një dritë e thellë, e pakuptueshme. Ke gjashtë vjet që punon tek ai, që pas një moti si mbarove shkollën me pesë klasë. Po të afron koha të vesh ushtar, dhe je akoma në gjysmë të zanatit. Ah, jo, bir, s'të jep njeri zanat kaq kollaj, po nuk pate vetë sy që ta rrëmbesh, — dhe i hodhi nipit një vështrim anash, nga poshtë-lart. — Më merr vesh, bir?

— Poo! — u përgjigj djaloshi me ngurrim. U largua e doli në rrugë. E ëma, që e kërkonte, doli në oborr. Hodhi një vësh-

— Do të flas. Do të them çdo gjë, por edhe ti të më flasësh drejt. Kështu?

— Medoemos. Të jesh i sigurtë.

— Nuk e di, po ka ca kohë që çoç po vë re. Më duket se shokët po druhen prej meje. Flasin veças. Qëndrojnë larg. Se ç'kanë. Unë nuk e di, sikur s'jam grindur ndonjëherë me ta. Këtë punë s'e marr vesh, Dita.

— Po ti a je afruar?

— E si të afrohem?... Ata rrinë larg!

— Ti, Vangjel, jeton midis njerëzve si i huaj. Nuk afrosh me shokët dhe ata nuk të afrohen. Ti pyet «ç'kanë shokët?!»: Ma merr mendja se edhe ata pyesin «ç'ka Vangjeli?!»... Ee, Vangjel... Sot brezi ynë i ri ka detyra...

— Detyra? — Vetullat kaleshe lëvrinë, duke sajuar sipër hundës një rrudhë të pleksur.

Atë çast një grup oficerësh fashistë, të pispillosur, që bridhnin ngeshëm sokakëve, kaloi në rrugë. Njëri prej tyre bashkoj gishtat e dorës, i yuri në buzë dhe, duke vështruar me çap-këllëk, e përshëndeti:

— Salve, bela mia!)

Vetullat e Vangjelit u rrudhën në çast rrëmbyeshëm. Balli i tij u err. Sytë i lëshuan xixa. Murmuriti me dhëmbë të shtrënguar:

— Qentë!

Vështrimi i vajzës, që nuk i ndahej fytyrës së djaloshit, u ndez nga një flakë kënaqësie të thellë. Ndërkohë fashistët u larguan tërë zhurmë.

— I pe?

— I kam parë sa më kanë mbirë në sy maskarenjtë!... Ç'farë e keqe!

— Dhe kjo farë e keqe u ngul në truallin tonë amëtar. — Vajza vështroi fytyrën e shokut të saj.

— Ke hak, Dita.

Pasoi një heshtje e shkurtër.

— Po, Dita, ti ke hak. Herë-herë më kujtohen ato që na thoshte xhaxhai, kur ishim të vegjël, e mendoj: «Ç'kërkojnë këta te ne? Kush i ftoi këtu?»

1) (it) — Tungjatjeta, bukuroshja ime!

— Tradhtarët!
 — Dhe na u shtruan në vatër, sikur të qenë zotë shtëpie!
 Dita e ngacmoi:
 — Epo, ja, ... sot ata janë zotë shtëpie!
 — Jo, ata janë të huaj. Zotë shtëpie jemi vetë!
 Dita iu afrua djaloshit më pranë dhe i mbështeti dorën në sup.
 — Dëgjo, Vangjel, ti i ngjan një barke mbushur plot me të mira, por pa busull!
 — Më paska humbur busulla?
 — Si duket!
 — E ku mund ta gjej?
 — Midis shokëve. Afrohu me ta.
 Djaloşi po mendohej. Afërdita e ndiqte me sy. Ajo kup-
 tonte se në ndërgjegjen e djaloshit bëhej luftë.
 — Ti, Dita, ç'ç më the për detyra. Ç'janë këto detyra?
 — Ajo e ngacmoi përsëri:
 — Të interesojnë?!
 — Posi!
 — Atëherë gjeji!
 — E ku t'i gjej?!
 — Midis shokëve!
 — Hëm! Edhe ti, Dita, ç'ç po më fsheh! S'po më flet ha-
 pur. Po më hedh sa andej-këtej.
 — Jo, Vangjel, poo... — Vajza donte të fliste më çiltër,
 por rregullat e konspiracionit nuk lejonin. Ndodhej në pozitë
 të vështirë. Vangjelin duhej ta orientonte.
 «Edhe sikur t'i cënoj pak rregullat, s'prish punë. Fitojmë
 një shok!» — i dha karar.
 — E njeh Petritin?
 — Cilin Petrit?
 — Petrit Shkëmbin.
 — Posi. E kam shok. Në shkollë kemi qenë bashkë... Kup-
 tova, Dita. Mirë... Po flas me Petritin... Edhe ai më rri larg,
 poo...
 — Afrohu ti! — e këshilloi ajo.
 Vangjeli u çua nga sofati i portës. Ndiqte uri. U kuj-
 tua që nuk kishte ngrënë mëngjes.
 — Më fal, Dita, unë po shkoj.

— Si të duash. Vetëm mos na harro.

Djaloshi u ndie i lchtësuar. Këtë ndryshim e vuri re edhe e ëma në shtëpi. Mendjen e kishte te Dita, te fjalët e saj si të hedhura rrotull. Çiltëria e vajzës dhe interesimi i saj po i hiqnin nga sytë një perde të errët. Djaloshi e kujtonte me kënaqësi takimin me Ditën. E kishte shoqe fëmijërie. Sa herë kishin luajtur bashkë! Kur ishin fëmijë, hynin e dilnin te njëri-tjetri, deri sa vëllai i Ditës, një vit më i madh se Vangjeli dhe tre vjet më i madh se ajo, u nis për në kurbet. Vangjeli kishte pasur shoqëri të ngushtë me vëllanë e Ditës. Shokët i quanin me të qeshur «dy vëllamët». Vangjeli qe miqësuar edhe me Ditën. Largimi i vëllait të Ditës në kurbet krijoi një boshllëk në jetën e Vangjelit. Dukej sikur kjo miqësi e vjetër po shuhej vetiu.

Dita jetonte me t'ëmën. I ati punonte çirak në Tiranë. Vetëm një herë në vit kthehej në familje, ku ishte më tepër mysafir, sesa kryefamiljar. Barra e shtëpisë kishte rënë prej kohësh mbi t'ëmën, një grua serioze, e fortë dhe energjike. Dita i ngjante shumë s'ëmës, si nga tiparet, ashtu dhe nga karakteri.

*
* * *

Petit Shkëmbi ishte shok i Vangjelit. Qenë nga lagje të ndryshme, por i kishin miqësuar vitet e bukura të shkollës. I ati punonte murator. Ishte mjeshtër i hollë gurskalitës.

«Po ku kishte fuqi cmilari im të mbante gjallë një vatër fëmijë! E hoqa djalin sapo mbaroi shkollën dhe e mora pas», — përsëriste me trishtim sa herë vinte biseda me shokë. Djali iu bë krah në moshë të njomë. Edhe ai kishte duar të arta. Kohët e fundit djali çoç po lëvizte. Babai hallelxhi u shqetësua: «Mos më marrë djali rrugë të keqe!» Një pasdreke i biri i shpunin në shtëpi një grup të rinjsh. Ata u hoqën mënjanë e bisedonin me zjarr. Babai kuptoi si qenë punët.

«U bëra njësh me djalin», — i thoshte ndonjë shoku të besuar. Plaku dëgjonte me kujdes e vëmendje të thellë traktet e komunikatat që lexonte i biri.

«Nuk na solle ndonjë nga ato kartëra, more djalë?» — thoshte nganjëherë.

Petriti kishte kohë që kërkonte të takohej me Vangjelin, por shoku shmangej pa kuptim.

«Xha Dhimoja është bërë nopran dhe Vangjeli po mbyllet në guaskë. Duhet shkundur!» — mendonte ai. Biseda me Afërditën një mëngjes, kur i kishte çuar komunikatat, i kishte forcuar besimin se do t'ia arrinte qëllimit.

Ajo që e habiste djaloshin ishte sjellja e plakut. «Sa ka ndryshuar xha Dhimoja! Nuk njihet fare. Ku është ai Dhimo Gërdushi që na fliste me zjarr kur qemë fëmijë për Luftën e Vlorës, që na fliste për kryengritjen e Qershorit... «Ja, djema, — na thoshte te Sheshi i Pazarit, — e shikoni atë ballkonin atje, tek ai dyqani të qoshja? Andej u foli Fan Noli njerëzve që mbushnin sheshin plot, kur shpalli kryengritjen kundër Ahmet Zogut!» Tani s'të vjen të besosh se ky plak dikur ka mbajtur pushkë në krah!»

Ishte pasdrekc. Iu kujtua se kishte lënë takim me Stefanin, zëvendëspërgjegjës të Forumit të Rinisë Komuniste të qytetit, për një çështje të grupit të vajzave, të cilën ia kishte njoftuar Dita. Bëri poshtë pazarit. Ndërkohë Stefani po vinte nga rruga e kovaçëve, ku kishte pasur takim me një shok të organizatës. U takuan ashtu si rastësisht, te çesma e pazarit, për të mos rënë në sy. Zbritën poshtë nga Kekot e u hodhën përtej Vjosës. Biseduan gjatë. Në fund Petriti e vërtiti bisedën ku duhej, shfaqti qëllimet e tij e kërkoj mendimin e shokut.

— Nuk e ke keq. Po të punojmë si duhet, Vangjeli bëhet shok i mirë... Të takon ty të punosh me të. Ti je i afërt, — miratoi Stefani.

— Mua më brengos më tepër sjellja e xha Dhimos. Ka ndryshuar shumë. Ai dikur...

— E di! Duhet të gjejmë shkaku!

— Ke të drejtë. Po fillojmë nga Vangjeli...

... Si u nda me Stefanin, Petriti mendoi t'i shkonte Vangjelit në shtëpi, por u pendua. Sikur të ndodhej xha Dhimoja aty, do të prishte shumë punë. Djaloshi matej, pa vepronte. «Do të fillojmë më parë nga Vangjeli e pastaj të arrijmë te xha Dhimoja». Me këto mendime i ra përmes Varoshit të Poshtëm. Kur arriti te Përroi i Bardhë, fare rastësisht, pa Vangjelin që po kalonte tek ura më poshtë. Bëri një gjysmërreth ashtu si kot dhe u gjend mbas krahëve të shokut kur ai e kishte kaluar